



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 81
Prishtinë, më 17 tetor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 17 TETOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Sabri HAMITI**.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare dhe procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës

Në fillim të mbledhjes, kryetari i njoftoi deputetët se debati parlamentar për këtë pikë ka qenë i radhitur në mbledhjen plenare të datës 11 tetor 2012. Mirëpo, për shkak të mungesës së Kabinetit qeveritar, deputetja Alma Lama, si propozuese e këtij debati kishte kërkuar shtyrjen e tij për mbledhjen plenare të radhës.

Kryetari e ftoi deputeten Alma Lama për ta paraqitur dhe për ta arsyetuar kërkesën për debat.

Alma Lama, në fillim të arsyetimit të kërkesës theksoi se këtë debat e ka kërkuar për të diskutuar në lidhje me shpërdorimin e parasë publike nga Qeveria e Kosovës, e cila gjatë periudhës 2010-2011 i ka shpërblyer me tenderë publike kompanitë që e kanë mbështetur fushatën elektorale.

Në vazhdim, ajo theksoi se korrupsioni mbetet problemi numër një sa i takon sundimit të ligjit në Kosovë, fakt ky i konstatuar në çdo Raport të Progresit për Kosovën, të përgatitur nga Komisioni Evropian.

Më tej, ajo tha se praktikët korruptive janë të shprehura veçanërisht në fushën e prokurimit publik, i cili në mënyrë të vazhdueshme i shpërblen kompanitë, të cilat janë të lidhura me Qeverinë. Me gjithë faktin se Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për financimin e partive politike, me të cilin sanksionohet kjo logjikë korruptive, prapëseprapë kjo gjë nuk është ndryshuar në praktikë, ndërsa theksoi gjithashtu se nuk po zbatohet Ligji për prokurimin publik.

Deputetja Lama më pas u fokusua, siç tha, në të dhënat e kryera nga gazeta investigative “Priort”. Faktet e publikuara në gazetë do të duhej të kishin shërbyer si bazë për nisjen e hetimeve ex officio nga Prokuroria, mirëpo diçka e tillë nuk ka ndodhur, tha ajo.

Më tutje, deputetja Alma Lama u ndal në një studim të UNDP-së, që përshkruan gjendjen aktuale të varfërisë në Kosovë, për të konstatuar se vlerësohet që rreth 16,7% e popullatës së Kosovës jeton në varfëri ekstreme, ndërsa rreth 45% e popullatës konsiderohen të varfër.

Këto shifra të varfërisë janë alarmante, por kjo gjendje e rëndë nuk trajtohet me seriozitet nga Qeveria, për më tepër abuzohet me paranë publike. Kjo mënyrë e përdorimit të tenderëve publikë për financimin e fushatës nga një parti politike i ka edhe dy pasoja të tjera të rënda.

Së pari, krijon pabarazi ndërmjet subjekteve politike dhe në këtë mënyrë një parti e blen pushtetin me paratë e taksapaguesve. Dhe, së dyti, duke qenë se në tenderë publikë mund të konkurrojnë edhe kompani të huaja, rrezikohet komprometimi i pushtetit nga këto kompani dhe futja e kapitalit të huaj për qëllim të blerjes së pushtetit dhe rrjedhimisht edhe vetë shtetit, konstatoi ajo.

Kuvendi i Kosovës, si organ mbikëqyrës i punës së Qeverisë, ka përgjegjësi të madhe dhe duhet ta luajë rolin, për të cilin është mandatuara, duke kërkuar llogari nga Ekzekutivi për mënyrën e shpenzimit të parasë publike, theksoi ajo.

Diskutimi i plotë i deputetes Alma Lama është dhënë në transkript.

Më pas, kryetari e hapi debatin lidhur me pikën e lartpërmendur.

Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se parimisht jemi mbështetës të çdo debati, që është në interes të qytetarëve dhe që i kontribuon rendit dhe ligjit në vendin tonë, në veçanti administrimit sa më të mirë të financave publike.

Shpenzimi i parasë publike është i rregulluar me kornizën ligjore, e cila i përcakton qartë mandatin dhe përgjegjësitë e organizatave buxhetore, në menaxhimin e fondeve publike.

Ministria e Financave, bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, rregullisht paraqet në baza periodike Raportin financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Raporte të tilla, përveçse diskutohen dhe miratohen në institucione, përfshirë edhe Kuvendin, ato bëhen publike në ueb-sajtin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Po ashtu, Qeveria e ka përgatitur dhe aprovuar edhe dokumentin e politikave të kontrollit të brendshëm të financave publike dhe procedurave për menaxhim financiar dhe kontroll.

Në këtë drejtim, rregullisht paraqitet edhe Raporti për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, theksoi ai.

Në raportet e Auditorit për fushatat zgjedhore, për zgjedhjet lokale 2009 dhe për zgjedhjet qendrore 2010, janë vlerësuar si shembull që i kemi deklaruar të gjitha shpenzimet e ndara edhe për degë. Janë raportet e Auditorit për vitet 2009 dhe 2010 ato që na dëshmojnë se në detaje e kemi pasqyruar listën e donatorëve, të gjitha të hyrat që kanë qenë konform kuadrit ligjor. Kjo dëshmon që Qeveria Thaçi i ka respektuar fuqimisht procedurat ligjore, gjithnjë duke mos i parë taksapaguesit kosovarë me orientim politik, siç pretendohet këtu, theksoi ai.

Diskutimi i plotë i deputetit Ramiz Lladrovci është dhënë në transkript.

Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se parashtrimi i një nocioni të kësaj natyre është i arsyeshëm dhe është shumë normale që të ndodhë, është e shëndetshme për vetë Qeverinë e Kosovës.

Në rrethanat, në të cilat punojmë, vërehet se ka shumëçka që ngel për t'u dëshiruar.

Ai më pas iu referua disa fakteve, nëpërmjet të cilave ka kaluar Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Kosova e ka një progres në paraqitjen e formës së prezantimit të pasqyrave financiare, por ajo është veç një auditim i formës se si janë prezantuar tabelat, por jo edhe në brendinë e tij, jo edhe performansën e tij. Të tilla nuk kemi dhe aty ngel. Unë e kam shtruar këtë çështje shumë herë edhe këtu në Kuvend, që Zyra e Auditorit ka për detyrë dhe ne duhet ta detyrojmë atë që sa më shpejt të ketë staf profesional në trajtimin e performansës së institucioneve, tha ai.

Nëse i bëjmë një vështrim, ta zëmë vitin e kaluar, ku prej rreth 40 raporteve të auditimit që i kemi shqyrtuar vetëm një rast e kemi gjetur që nuk ka pasur shkelje, konstatoi deputeti Sadriu.

Po t'i referohemi Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe Ligjit mbi prokurimin, tre muajt e fundit të vitit kalendarik janë vite që kanë reduktime drastike në përdorimin e fondeve për investime.

Ne themi se dyshojmë që ka keqpërdorime dhe kërkojmë që ato të hulumtohen, të investigohen më tutje, por ato nuk ndodhin. Auditori na thotë se ka ngrehur shumë çështje, për të cilat ka kërkuar trajtim specifik të çështjes së caktuar, po ato i ka çuar në EULEX, e jo edhe në institucione tona.

Deputeti Sadriu e kritikoi hyrjen në obligime pa zotime dhe kjo është frika, që unë mendoj se po të ngrihet kjo temë dhe të trajtohet në mënyrë profesionale, ne do ta kemi një gjendje tjetër.

Në fund ai tha se është mirë që ngritur ky debat dhe të diskutojmë, pa tendenca të politizimeve të skajshme, duke kërkuar nga deputetët që ta ruajnë dinjitetin e Kuvendit.

Diskutimi i plotë i deputetit Ali Sadriu është dhënë në transkript.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", tha se dua ta filloj fjalën time për nënshkrimin e kontratës, që ka ndodhur sot për privatizimin e rrjetit të Distribucionit të KEK-ut, me të cilën Qeveria e Kosovës po deklaron se do t'i fitojë 26,3 milionë euro, por asnjëherë nuk na ka treguar se çka po jep për këto 26,3% milionë euro.

Ai më pas sqaroi se sot deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë ndaluar nga Policia e Republikës së Kosovës me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme, siç tha, për të hyrë në objektin qeveritar dhe Policia dhunshëm i ka nxjerrë jashtë nga oborri qeveritar dhe ua ka mbyllur edhe derën e hyrjes në Kuvend.

Po të kishim pasur shtet të së drejtës këtu, po të kishim pasur Gjyqësor të pavarur dhe profesionistë, natyrisht që ky debat dhe ky raport i organizatës “ÇOHU” do të shndërrohej në akuzë shumë lehtë. Por, meqenëse nuk kemi Gjyqësor të pavarur, atëherë natyrisht që duhet ta debatojmë këtë çështje në Kuvend, konstatoi ai.

Më tej, ai e kritikoi mungesën e kryeministrit, të ministrit të Financave dhe ministrit të Zhvillimit Ekonomik, si faktorë të rëndësishëm për debatin në këtë temë.

Ne, pra, i paraqitëm faktet dhe është një hulumtim, që nuk e ka bërë Lëvizja “Vetëvendosje”, po e ka bërë një organizatë e shoqërisë civile, e cila edhe kur e ka publikuar këtë raport e ka lutur Qeverinë dhe të gjithë ata që përmendëm këtu që të përgënjeshtrohet, por ky përgënjeshttrim nuk ka ndodhur.

KEK-u është kompani publike, e cila së bashku me PTK-në janë dy prej kompanive, të cilat më së shumti janë dëmtuar prej vitit 1999 dhe këto dëmtime kanë qenë të qëllimshme. Pra, siç i ka ndodhur Postës dhe Telekomit të Kosovës, me intervenim të drejtpërdrejtë të politikës nga lart nëpërmjet bordeve dhe nga poshtë nëpërmjet agjentëve, që i kanë futur aty si të punësuar, ashtu i ka ndodhur edhe KEK-ut.

Ai, në fund, foli edhe për transparencën e financave publike të partive politike dhe për gjendjen në sektorin e energjisë në Kosovë dhe më gjerë.

Diskutimi i plotë i deputetit Visar Ymeri është dhënë në transkript.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se tema, për të cilën sot po debatojmë është goxha e gjerë, kemi pasur diskutime shumë herë, po asnjëherë të strukturuar. Mendoj se sot kemi gjasë që të kemi debat të strukturuar, përpos deklaratimit të fakteve, të cilat janë të pamohueshme.

Mendoj se fakti që ka pasur abuzim serioz me buxhetin e shtetit, prej nivelit komunal deri në nivelin e përgjithshëm, është i pamohueshëm. Ky është një aspekti i parë, ndërsa aspekti i dytë është menaxhimi i parasë publike, respektivisht planifikimi i gabueshëm i shpenzimit të mjeteve. Si shembull të tillë ai e përmendi faktin se për tre vjet Qeveria e Kosovës ka punuar me kompani vendore, të cilat kanë investuar në makineri dhe në kapacitete, për një moment janë ballafaquar me bankrotim, kur Qeveria ka filluar ta punojë autostradën me kompani të huaja.

Janë ndërtuar shkolla, e tash shihet që i kanë nga 3 ose 4 nxënës, ose fare. Janë shpenzuar mjetet, me një qëllim të mirë, krejt në rregull. Duhet të ndërtojmë shkolla, ama nuk ka pasur proces të të menduarit, nuk ka pasur proces, i cili do të sillte vendime normale me efekt pozitiv afatgjatë, jo vetëm me efekt pozitiv dy-tre ose katërmujor, ose për propagandë, konstatoi ai.

Në vazhdim ai foli edhe për mënyrat për luftimin e korrupsionit dhe të abuzimit me buxhet.

Aleanca mendon se pa u dënuar njerëzit që kanë vjedhur nuk kemi gjasa as teorike për ta luftuar korrupsionin afatgjatë dhe kjo është alfa e krejt luftës kundër korrupsionit, tha ai.

Diskutimi i plotë i deputetit Ardian Gjini është dhënë në transkript.

Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, tha se në lidhje me çështjen e shpërdorimit të parasë publike, ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës e kemi miratuar një pako të ligjeve dhe në vitin e kaluar e kemi miratuar Ligjin e prokurimit publik, në bazë të rekomandimeve të Komisionit Evropian, për arsye që llogaridhënia dhe transparenca për menaxhimin e parasë publike të jetë sa më e mirë.

Në vazhdim, ajo kërkoi që në Kosovë të ketë zbatueshmëri më të mirë të Ligjit, institucionet kompetente të jenë më të qarta gjatë dhënies së tenderëve, dhe të dihet në fund raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm mbi shfrytëzimin e parasë publike.

Pushtetet në Kosovë janë të ndara dhe në rast se ne kemi dyshime për keqpërdorime, atëherë rruga është diku tjetër, theksoi deputetja Selmani

Diskutimi i plotë i deputetes Myzejene Selmani është dhënë në transkript.

Në këtë debat morën pjesë edhe këta deputetë: Sabri Hamiti, Ganimete Musliu, Alma Lama, Teuta Sahatqija, Afrim Kasolli, ministri Bajram Rexhepi, ministri Bedri Hamza, Emin Gërbeshi, ministri Besim Beqaj, Albin Kurti, Hykmete Bajrami, Xhevahire Izmaqi, Xhevdet Neziraj, Haki Demolli, Salihe Mustafa, Ahmet Isufi, Albulena Haxhiu, Shaip Muja, Gëzim Kelmendi, Armend Zemaj, Valbona Dibra, Blerta Deliu-Kodra, Sala Berisha-Shala dhe Liburn Aliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund të diskutimeve, deputetja Alma Lama i propozoi Kuvendit që të miratojë rekomandimet në katër pika.

Kryesuesi i hodhi në votim rekomandimet e paraqitura nga deputetja Alma Lama lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 28,
Kundër ----- 35,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk i miratoi rekomandimet e propozuara nga deputetja Alma Lama lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës gjatë periudhës 2010-2011.

Kryesuesi i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes plenare në orën 14:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale